



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Kuvendi i Komunës

Nr. 02/ 341

Datë: 12.09.2018

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d, nenit 14 paragrafi 14.1, nenit 17 pika c, nenit 40 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr.28/15 qershor 2008, nenit 6 të Udhëzimit Administrativ (MTI) nr.15/2016, për mënyrën e themelimit, funksionimit dhe administrimit të inkubatorëve të biznesit, nenin 10 paragrafi 2, nenin 19 dhe 46 të Statutit të Komunës së Malishevës nr.01/871 të datës:12.11.2008, Kuvendi i Komunës së Malishevës në vazhdimin e dytë të mbledhjes së -IX- të mbajtur me datë: 07.09.2018 merr këtë:

V E N D I M

PËR THEMELIMIN DHE CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E INKUBATORIT TË BIZNESIT TË KOMUNËS SË MALISHEVËS

1. Miratohet kërkesa nr.01/1228 e datës:22.08.2018 e parashtruar nga Kryetari i Komunës për themelimin dhe caktimin e lokacionit për ndërtimin e Inkubatorit të Biznesit të Komunës së Malishevës.
2. Lokacioni për ndërtimin e inkubatorit të Biznesit të Komunës së Malishevës planifikohet në pjesën e ngastrës kadastrale nr.P-72310047-00507-1 në vendin e quajtur Stapanica-Lluga, arë e klasit 3 në emër të OPB “Mirusha”, në sipërfaqe prej 2404 m², dhe P-72310047-00506-1 në vendin e quajtur Stapanica-Lluga, arë e klasit 3 në emër të OPB “Mirusha”, në sipërfaqe prej 3454 m² ZK-Malishevë, prona këto të bartura me marrëveshje nga administrimi i Agjencisë Kosovare të privatizimit nën administrimin e Komunës së Malishevës.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë lokacioni i propozuar, kopjet e planit, certifikatat pronësore, kërkesa e Kryetarit të Komunës me materialin përcjellës.
4. Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Shërbim Pronëso-Juridik që pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi të zbatojë të gjitha procedurat e nevojshme ligjore për përcaktimin e pikave përkufizuese në teren lidhur me ndërtimin e Inkubatorit të Biznesit
5. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, përmes Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Shërbim Pronëso-Juridik dhe Drejtorisë për Urbanizëm.
6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 17 të Rregullores nr.01/2017, për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të Komunës, dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet:
Arkivit të Komunës
Drejtorive të KK-së
MAPL-së.



Kryesuesi i Kuvendit
Rrahim Morina



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E MALISHEVËS



Kryetari i Komunës

Nr. 01/___

Datë; 07/08/2018

22-08-2018

01-1228


Për: Kuvendin e Komunës së Malishevës
Kryesuesit z. Rrahim Morina.

Nga : Kryetarit të Komunës së Malishevës, Ragip Begaj.

Kopje : Arkivit të komunës.

Datë: 07.08.2018

Lënda: Kërkesë për themelimin e Inkubatorit të Biznesit të Komunës së Malishevës.



Të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës,

Duke marrë për bazë nenin 6, të Udhëzimit Administrativ për mënyrën e themelimit, funksionimit dhe administrimit të inkubatorit të biznesit nr.15/2016, dt.14.10.2016, me anë të kësaj shkrese kërkojë nga ana e juaj shqyrtimin dhe marrjen e vendimit për Themelimin e Inkubatorit të Biznesit në Komunën e Malishevës.

Për caktim lokacioni është planifikuar të ndërtohet në pjesën e ngastrës kadastrale nr.P72310047-00507-1, në vendin e quajtur Stapanica-Lluga, arë e klasit 3, në emër të OPB " Mirusha ", në sipërfaqe prej 2404 m² dhe P-72310047-00506-1, në vendin e quajtur Stapanica-Lluga, arë e klasit 3, në emër të OPB " Mirusha " ZK-Malishevë.

Duke pasur mirëkuptimin tuaj, kërkesës në fjalë ja bashkëngjisim, dokumentet përcjellëse, të cilat janë pjesë e kësaj kërkesë.

Ju faleminderit për mirëkuptim!

Me respekt,



Republika e Kosovës
Komuna e Malishevës



Për : Komitetin për Politik dhe Financa / Malishevë

Nga : Drejtorati për Urbanizem

05 Nr. _____

Më:

21-06-2018

07257-

Lënda: Kërkesë për Ndërtimin e Inkubatorit të Bizneseve në Malishevë

Kërkojmë nga Komiteti për Politikë dhe Financa që ta përkrahë dhe shqyrtoj propozimin për ndërtimin e Inkubatorit të Bizneseve në Komunën e Malishevës në vendin e quajtur "Stapanica-Lluga", parcella nr. P-72310047-00506-1 dhe P-72310047-507-1 (pronë e OPB Mirusha) zona kadastrale Malishevë. Ky projekt pritet të financohet nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë për këtë vitë dhe lind nevoja e shqyrtimit dhe propozimit për miratim në Ansamblenë Komunale. Drejtoria e Urbanizimit e ka të hartuar projektin kryesor detal.

PROPOZIMI:


Miratimi i propozimit për projektin Ndërtimin e Inkubatorit të Bizneseve në Malishevë.

Andaj kërkoj nga KPF që ta shqyrtoj këtë kërkesë dhe të vendos në favor pozitiv.

Ju faliminderit.

Drejtori,

Ing. Islam Vrenezi



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
 PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. _____
 Br. _____
 No. _____
 Nr. i Fq. _____
 Br. Str. _____
 No. Pg. _____

Prishtinë / _____

Data : 05 OCT 2016
 Datum : _____
 Data : _____

7025
 23

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
 KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
 PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO



PRANILJE
 ACCEPTED ON 12-10-2016
 PRANILJEVO:
 Nr.No.Br. 01-1250

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

në mes të

Agjencisë Kosovare të Privatizimit ("AKP")

dhe

Komunës së Malishevës

Lidhur me transferimin e NSH "Kosovatrans"-stacioni i autobusëve në Malishevë tani NP "Kosovatrans"-stacioni i autobusëve me seli në Malishevë

Duke pasur parasysh se Agjencia Kosovare e Privatizimit është organ i pavarur publik i themeluar me Ligjin Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, me mandat ligjor për administrimin e ndërmarrjeve shoqërore, duke përfshirë autorizimin për shitjen, transferimin dhe/ose likuidimin e këtyre ndërmarrjeve dhe aseteve të tyre;

Duke pasur parasysh se në kuadër të mandatit administrues të Agjencisë Kosovare e Privatizimit, janë përfshirë edhe disa ndërmarrje të regjistruara si shoqërore të cilat në vazhdimësi kanë kryer funksione në interes publik të qytetarëve;

Duke pasur parasysh se Agjencia Kosovare e Privatizimit, në pajtim me Ligjin Nr. 04/ L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, neni 5 paragrafi 2, mundet që asetet të cilat sipas këtij ligji i administron, të bartë në përgjegjësi dhe administrim të një organi tjetër publik, përmes një rregullore ose ligj që është në fuqi dhe që është shpallur nga një autoritet kompetent publik në Kosovë pas 10 Qershorit 1999;

Duke pasur parasysh se Republika e Kosovës përmes Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, ka krijuar një numër të ndërmarrjeve publike, në nivel qendror, rajonal dhe lokal;

Duke pasur parasysh Ligjin për Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, ku në nenin 23 përfshinë listën Ndërmarrjeve Publike Lokale të themeluara nga asetet e ndërmarrjeve shoqërore "Kosovatrans" si ndërmarrje Publike Lokale "Stacione të Autobusëve";

Duke pasur parasysh Rregulloren Nr.02/2013 mbi Kriteret për Krijimin e Ndërmarrjeve Publike Lokale dhe Pjesëmarrja e Komunave në Bordet e Drejtorëve të Ndërmarrjeve Rajonale të Ujit, konkretisht nenin 4 të saj;

Palët në këtë Marrëveshje Mirëkuptimi:

I. Agjencia Kosovare e Privatizimit (më tutje AKP) duke vepruar në emër të Ndërmarrjes Shoqërore "Kosovatrans" njësia/stacioni i autobusëve në Malishevë, të cilën e përfaqëson Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve z. Petrit Gashi. Adresa e AKP-së është: rruga Agim Ramadani nr 23 Prishtinë;

dhe

II. Komuna e Malishevës e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës z. Ragip Begaj

pajtohen si në vijim:

Neni 1

Qëllimi i Marrëveshjes

Kjo MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ka për qëllim të rregulloj bashkëpunimin lidhur me transferimin e aseteve dhe detyrimeve të Ndërmarrjes Shoqërore "Kosovatrans" në Prizren, Njësia Punuese "Stacioni i Autobusave" në Malishevë, nga administrimi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit tek Komuna e Malishevës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2013 të Qeverisë së Republikës së Kosovës mbi "Kriteret për Krijimin e Ndërmarrjeve Publike Lokale dhe Pjesëmarrja e Komunave në Bordet e Drejtorëve të Ndërmarrjeve Rajonale të Ujit".

Me Ligjin për Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike nga personi juridik Ndërmarrja Shoqërore "Kosovatrans" (PRZ046) me seli në Prizren, janë krijuar Ndërmarrjet Publike Lokale "Stacioni i Autobusëve" në Prizren, "Stacioni i Autobusëve" në Suharekë, "Stacioni i Autobusëve" në Dragash, "Stacioni i Autobusëve" në Malishevë dhe "Stacioni i Autobusëve" në Rahovec

Neni 2

Përkufizimet

Shprehjet e përdorura në këtë Marrëveshje Bashkëpunimi kanë këtë kuptim:

"Marrëveshje Bashkëpunimi" - nënkupton këtë marrëveshje se bashku më të gjitha shtojcat e bashkëlidhura.

"Agjenci" – Agjencia Kosovare e Privatizimit e themeluar sipas Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji Nr.03 /L-067)

"Aset" – një aset, interes apo prone mbi të cilën Agjencia ushtron autoritetin administrativ në pajtim me Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji Nr. 04/L-034)

"Rregullore e Qeverisë së Republikës së Kosovës" – Rregullore Nr.02/2013 mbi kriteret për krijimin e ndërmarrjeve publike lokale dhe pjesëmarrja e Komunave në bordet e Drejtoreve të ndërmarrjeve rajonale të ujit

"Bordi i Drejtoreve" – Bordi i Drejtoreve të Agjencisë i cili përfaqësohet nga Kryesuesi i Bordit i cili është i emëruar nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës

"Komuna" – Njësia themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës e themeluar sipas ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligjit Nr. 03/L-040)

"Kryetari i Komunës" – organi me i lartë ekzekutiv i komunës i cili zgjidhet përmes zgjedhjeve të drejtpërdrejta.

"Ndërmarrja shoqërore" - një person juridik ashtu siç është përcaktuar në nenin 3.1.25 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe mbi të cilën ndërmarrja Agjencia ushtron autoritetin administrativ.

"Ndërmarrje" – ndërmarrje mbi të cilën Agjencia ushtron autoritetin administrativ në përputhje me Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

"Ndërmarrje Publike" - është term i përgjithshëm dhe përfshin të gjitha ndërmarrjet e përcaktuara në listat të cilat i janë bashkëlidhur Ligjit për Ndërmarrjet Publike (Ligjit Nr. 03/L-087) dhe Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.

Neni 3

Përmbajtja e Marrëveshjes së Bashkëpunimit

Palët nënshkruese të kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi pajtohen që në bazë të bashkëpunimit reciprok dhe për shkak të interesit të përgjithshëm publik të krijojnë kushtet e nevojshme që Komunitat në mënyrë sa më efektive të përmbushin nevojat komunale të qytetarëve, përmes realizimit të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 4

Obligimet nga Marrëveshja e Bashkëpunimit

Në momentin e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, palët obligohen që t'i përmbushin obligimet që dalin nga kjo marrëveshje të cilat janë paraqitur si në vijim:

4.1 Obligimet e Agjencisë:

- a) Agjencia e bën transferimin e aseteve dhe detyrimeve të Ndërmarrjes Shoqërore "Kosovatrans" njësia në Malishevë në administrimin dhe autorizimin e Komunës së Malishevës, me qëllim që Komunitat përkatëse të jenë sa me efikase në realizimin e interesave publike të qytetarëve ose në ushtrimin e autoritetit zyrtar si njësi organizative qeverisëse;
- b) Agjencia me rastin e transferimit të aseteve dhe detyrimeve të kësaj ndërmarrje të përshkruara më lartë tek Komuna e Malishevës, do të ofroj të gjithë dokumentacionin relevant në dispozicion të ndërmarrjes përkatësisht AKP-së, të dhëna këto të paraqitura në formë të Shtojcave të kësaj Marrëveshje.
- c) Agjencia edhe pas transferimit të finalizuar të aseteve dhe detyrimeve të përshkruar më lartë, do të jetë e gatshme për ofrimin e informatave dhe dokumentacionit në lidhje me ndërmarrjen dhe çështjeve të ndryshme të cilat lidhen me ndërmarrjen, aq sa kjo e para posedon;

4.2 Obligimet e Komunës:

- a) Komuna e Malishevës, obligohet që të marr në menaxhim dhe administrim njësinë e Ndërmarrjes Shoqërore "Kosovatrans" stacionin e autobusëve në Malishevë me të gjitha asetet dhe detyrimet e transferuara nga pika 4.1 a e këtij Memorandumi dhe të ushtroj kompetencat në pajtim me Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligjin për Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, si dhe Rregulloren Nr. 02/2013 mbi Kriteret për Krijimin e Ndërmarrjeve Publike Lokale dhe Pjesëmarrja e Komunave në Bordet e Drejtorëve të Ndërmarrjeve Rajonale të Ujit.

Neni 5

Implementimi dhe Ndryshimet i Marrëveshjes

Për implementimin e kësaj Marrëveshje, Agjencia dhe Komuna do të angazhojnë organet me të larta vendimmarrëse, ndërsa me autorizimin e tyre mund të caktohen edhe personat e tjerë përgjegjës për bashkëpunimin e mëtutjeshëm dhe shkëmbim të informatave pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshje.

Neni 6

Efkti juridik i Marrëveshjes Bashkëpunimit

Kjo Marrëveshje në mes të Agjencisë dhe Komunës së Malishevës do të ketë efektin e titullit juridik përmes të cilit bëhet transferimi i autorizimeve dhe kompetencave administrative nga Agjencia tek Komuna e Malishevës mbi asetet dhe detyrimet e Ndërmarrjes Shoqërore "Kosovatrans" stacionit të autobusëve në Malishevë.

Neni 7
Numri i kopjeve të Marrëveshjes

Marrëveshja Bashkëpunimit është nënshkruar në 4 kopje, nga një kopje origjinale për secilën palë nënshkruese.


Neni 8

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës do të ketë juridiksion ekskluziv lidhur me shqyrtimin e çfarëdo kontesti midis palëve në lidhje me këtë Marrëveshje.

Neni 9
Hyrja në fuqi

Palët nënshkruese pajtohen që kjo Marrëveshje e Bashkëpunimit hynë në fuqi nga dita e nënshkrimit nga ana e tyre. Me nënshkrimin e saj, palët obligohen në realizimin me përpikëri të të gjitha pikave të saj.

Agjencinë Kosovare të Privatizimit:


Petrit Gashi
Kryesuesi i Bordit të Drejtoreve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Komuna e Malishevës


Ragip Begaj
Kryetar i Komunës




Prishtinë 21.10.2016

DREJTORIA PËR GJEODOZI, KADASTËR DHE PRONË



Parcela nr. / Parcel Nr:



E punoi / Operator:





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR / MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA / MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-72310047-00506-1

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:
Komuna / Opština / Municipality:
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: Malishevë / Malishevo / Malishevë

1903-2018

11.09.2018 - 08:52

Malishevë / Malishevo / Malishevë

MALISHEVË / MALIŠEVO / MALISHEVË

Malishevë / Malishevo / Malishevë

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësies kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësies Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-72310047-00506-1	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land	Urban	3454	Aktvendim Nr.06-111-2018 dt.06.02.2018	06.02.2018	

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendbanimi - adresa Prebivaliste - adresa Resident - address	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Hollësitë e adresës Pojednostoi adrese Address Details	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
STAPANICA-LLUGA/STAPANICA-LLUGA/STAPANICA-LLUGA		STAPANICA-LLUGA	06.02.2018	

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m²) Površina (m²) Area (m²)
1	Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture	Kullosat/Pashnjaci/pasture	Kullosë E Klasës 3/Pasnjak 3 Klasse/3rd Class Pasture	3454

B. PRONARË/POSEDEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posedim individual / Individualna Drzavina / single possessor	OPB MIRUSHA	KCID2300295	MALISHEVË / MALISEVO / MALISHEVĚ /			1/1	Kontratë Ev.nr.269/72 dt.22.09.1972	07.02.2018



Republika e Kosovës

Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR / MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA / MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-72310047-00507-1

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	1903-2018
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	11.09.2018 - 08:52
Komuna / Opština / Municipality:	Malishevë / Mališevo / Malishevë
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:	MALISHEVË / MALIŠEVO / MALISHEVË
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	Malishevë / Mališevo / Malishevë

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësies kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësies Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-72310047-00507-1	PARCELË / PARCELA / PARCEL	/ /	Urban	2404			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendbanimi - adresa Prebivaliste - adresa Resident - address	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address Details	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
STAPANICA-LLUGA/STAPANICA-LLUGA/STAPANICA-LLUGA		STAPANICA-LLUGA		



A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja Površina Area	(m²) (m²) (m²)
1	Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture	Arat/Njive/Arable	Arë E Klasës 3/Njiva 3 Klase/3rd Class Arable Land	2404	

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posëdim individual / Individualna Drzavina / single possessor	OPB MIRUSHA	KCID2300295	MALISHEVË / MALIŠEVO / MALISHEVĚ /			1/1		